

Bedri Rama

BIBLIOTEKA

85H-1

R 24

Kazma  
dhe  
nushka

8SH-P3-1

R 24

BIBLIOTEKA E MIKUT TË VOGËL TË LIBRIT

BEDRI RAMA

# KAZMA DHE PUSHKA

(Për moshën e ulët dhe të mesme  
shkollore)

30/94  
~~44169~~

  
BIBLIOTEKA NATIONALE SHKODRA

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



## KAZMA DHE PUSHKA

Prindët për ditlindje  
më bënë dhuratë,  
një kazëm të bukur  
dhe një pushk' të gjatë.

Babi tha: «Ne duam  
që një dit', o bir,  
punëtor të bëhesh  
dhe ushtar i mirë».

Oh, sa më gëzoi  
mua kjo dhuratë:  
në dor' mora kazmën,  
n'sup pushkën e gjatë!

Çak-çuk los me kazëm,  
me pushk', pam e pam:  
punëtor i shkathët  
dhe ushtar un' jam.

Unë që të dyja  
i dua njësoj,  
se çfar' bëj me kazmën,  
me pushkën e mbroj.

Ndaj dhe kur të rritem  
e të bëhem burrë,  
pushkën edhe kazmën  
s'do t'i ndaj un' kurrë!



## KUR JAM I LUMTUR

Kur bëj detyrat  
dhe kur mësoj,  
atëher' me gaz  
në shkollë shkoj.

Sa her' që ngrihem  
edhe marr dhjetë,  
më duket vetja  
si zog me fletë.

Prindët e mi  
kur i dëgjoj,

gazin që ndjej  
s'di ta tregoj.

Dhe kur ndihmoj  
un' shokun tim,  
nuk ka për mua  
më t'madh gëzim.

Kur bëj si m'thotë  
Mëma Parti,  
më mbushet zemra  
plot krenari!



## LAMTUMIRË, SHOKË!

Lamtumirë, shokë,  
unë sot po shkoj  
së bashku me prindët,  
në fshat të jetoj.


Babi do lërojë  
tokën me traktorë,  
mami do prashisë  
edhe do të korrë.

Unë jam i vogël  
Në shkollë mësoj;  
Po verës, me shokët  
Dhe un' do punoj.

### TAJOMA SHKOLLOR

Shkolla është një  
njëndësi e përgatitje  
shkollorë e cila dësh  
fisnikët si edhe qytetarët

Shkolla është një  
njëndësi e përgatitje  
shkollorë e cila dësh  
fisnikët si edhe qytetarët



## USHTARËT

Kur shkojn' ushtarët  
rrugët ushtojnë,  
me gaz fëmijtë  
pas tyre shkojnë.


Dhe un' sa herë  
që i shikoj,  
i përshëndes  
dhe i nderoj.

Sepse, kur prehem  
në shtratin tim,  
qëndron syhapur  
ushtari trim.

Kur fryn e bie  
dëbor' e shi,  
përgjon ushtari  
tej në kufi.

S'e mposht ushtarin  
asnje armik,  
Partia e bëri  
të fort' çelik!

Ndaj kur ushtarët  
në rrug' kalojnë,  
me gaz fëmijë  
pas tyre shkojnë!



## XHAXHI KARROCIERI

Para portës sime  
një karroc' ndalon,  
pastaj bie zilja  
dhe na lajmëron.


Un' vrapoj i pari  
dhe e përshëndes  
xhaxhi karrocierin,  
që më buzëqesh.

- Mirmëngjezi, xhaxhi!
- Mirmëngjezi, bir!

më thot' karrocieri,  
që vjen pa gëdhir.

Pastaj mbeturinat  
që mami i nxjerr,  
xhaxhi karrocieri  
në karroc' i merr.

Punën sa e kryen,  
«Mirupafshim!» thotë  
dhe i bie ziles  
në një tjetër portë.



## **MANI DHE MJOLLA**

Një man i bukur  
e degëgjerë,  
i bën oborrit  
hije në verë.

Dikur e mbolli  
atë im atë;  
vitet e rritën,  
e bën' të lartë.

Por tani trungu  
I është çarë,  
çhe s'gjelbëron  
më si më parë.

Prandaj një mjollë  
Mbolla prej tij  
Që manin tonë  
Ta përtërij.

Dhe shoh si rritet  
pak e nga pak,  
filiz' i ri  
pran' manit plak.



## RINA DHE ÇERDHJA

Rina pyeti e habitur:  
 — Babi, kush ja paska ngritur  
~~dallandyshes nén ballkon~~  
~~çerdhen ku po cicéron?~~

I tha babi: — Bija ime,  
 me përpjekje e mundime  
 ajo vet' e ka ndërtuar  
 bar e balt' duke gatuar.

Rina shihte me habi  
çerdhen që me aq mjeshtri,  
nën ballkon e kishte bërë  
dallandyshja bishtgérshërë.

Pastaj thirri me gëzim:  
— Edhe un', o babi im,  
si dallandyshja punëtore  
do të bëhem muratore!



## BABI IM

Për çdo ditë në mëngjes  
babi ngrihet me kujdes  
dhe pa bërë fare zhurmë,  
bëhet gati për në punë.

Ndërsa unë énde flej,  
nëpër gjum' sikur e ndjej,  
kur m'afrohet dalngadalë  
dhe më puth ai në ballë.

30184  
44169 LIBRIKA E  
DARDELLA PUBLIKUAR

Sa shpejt zgjohem atëherë  
dhe ashtu gjith shend e verë,  
babin pran' kur e shikoj,  
me dy duart e pushtoj.

Oh, sa dua ta ndjek pas,  
kur në punë shkon me gas!  
Po të kisha mundësi,  
do t'punoja si ai.

## PO T'U PRISH KARROCA

Po t'u prish karroca  
Kur me të po lot,  
mos u dëshpëro  
dhe mos qaj më kot.

Shpejt përvishi krahët  
edhe gjeje vetë  
se ku është prishur  
dhe çfar' ka të metë.

Po i doli rrota,  
gozhdën fap e fap!,  
me çekiç godite  
dhe mbërtheje prap.

Në t'u prishtë fare  
karroca që ke,  
me sharr' e me gozhdë  
ndërto një të re.




## LIBRI

Libri mua më mëson  
mbi çdo gjë që na rrethon:  
e kam shok e mik në jetë  
dhë mësues të vërtetë.

Nuk e humb kohën e lirë,  
por me ngulm e me dëshirë  
më pëlqen t'lexoj çdo ditë,  
t'i njoh botës fshehtësitë.

Librin un' gjithnjë e çmoj,  
pse aty mendjen ndriçoj:  
mësoj ç'ndodh e çfar' ka ngjarë  
si tani edhe më parë.




## S H I U

Pemët po përkunden,  
era fishkëllon,  
dita u bë natë,  
qielli po gjëmon.

Shkrepëtin rrufeja,  
retë ndizen flakë,  
ja, pikat e para  
bien pak nga pakë.

Një voglush i zbathur  
shpejt vrapon te dera,  
qesh e lot me shiun,  
flokët ja prish era.

Atje përmes fushës  
kur shiu pushon,  
prap gjëmon traktori  
dhe tokën lëron.



## MAKINA E UJIT

Plot makina rrugës  
kalojnë çdo ditë,  
por më shumë njera  
i gëzon fëmijtë.

Ty-ty-ty burinë  
sapo ja dëgjojnë,  
në rrugë të gjithë  
dalin ta shikojnë.

— Erdh makin' e ujit!  
— Ja, ku po afron!

dhe me gisht secili,  
shokut ja tregon.

N'dy krahët makina  
derdh ujët si shi:  
rrugët e qytetit  
mbushen plot freski.

Aty buzë rrugës  
fëmijët, me gas,  
qeshin e thërrasin,  
por s'e ndjekin pas...



## NË U BËFSHA

Në u bëfsha agronom,  
do mbjell vreshta e limon  
dhe me grurë mot për mot,  
do t'i mbush hambaret plot.

Po u bëra minator,  
traktorist a murator,  
mjak, mësues a inxhinier,  
do t'punoj kudo me nder.


Se ç'do bëhem, nuk e di,  
se akoma jam fëmi,  
por sot duhet të mësoj  
që të di si të punoj.



## QUKAPIKU

Ja, dëgjo si po çukit  
përmbi dru një qukapik  
dhe insektet po i zhduk,  
duke bërë çuk-çuk-çuk!

Qukapik, o qukapik,  
sqepi yt porsi çelik;  
sa her' bën ti çuk-çuk-çuk,  
krimbat s'din' ku me u struk.




## R R U S H I

Nëpër vreshta e hardhi  
u zverdh rrushi e u nxi;  
plot me kokrra çdo kopan,  
dega sa mezi i mban.

Ca të verdhë si flori,  
ca të kuqe e ca të zi;  
oh, sa shum' që na shijojnë,  
gojën mjalt' na ëmbëlsojnë!

Plot me vreshta, plot me rrush  
çdo bregore sot u mbush;  
dor' e artë kudo mbolli  
ç'bukuri vendit i solli!



## KAM DY PESHQ NË AKUARIUM

Kam dy peshq në akuarium,  
që të dy i dua shumë:  
kur i shoh se qysh notojnë,  
oh, sa fort që më gëzojnë!

Njeri është rrumbullak,  
kur të sheh, s'trembet aspak;  
kurse tjetri sa të ndjen,  
zhytet thell' e dot s'e zen.

Peshqëve në akuarium  
mish të grirë u hedh unë  
dhe çdo ditë në mëngjes,  
ua ndrroj ujët me kujdes.

Pranë akuariumit tim  
rri shpesh herë me gëzim:  
sodis peshqit ngjyrë ar,  
që notojnë të pandarë.



## YLLI I KĒPUTUR

Qiellin plot yje  
duke vështruar,  
një vajz' e vogël  
fort ish hutuar,


Se pa një yll,  
që ra papritur,  
**një yll të vogël**,  
një yll të ndritur.

Ç'i kishte ndodhur  
yllit të bukur?!  
Pse vall' nga shokët  
ishte shkëputur?!

Moj vogëlushe,  
mos u mërzit,  
që yll' i bukur  
më nuk po ndrit.

Kurrgjë në botë  
nuk rron ngaherë,  
ca yje shuhën  
ndizen të tjerë.

Dhe qelli kurrë  
s'mbetet i shkretë,  
por plot me yje  
ndriçon për jetë!



## SI U GËNJYE GIMI

Irma edhe Gimi  
kishin në shtëpi,  
një pulë të zezë  
dhe një gjel të ri.

I tha Irma Gimit:  
— Cilin dëshiron,  
këtë pul' të zezë  
a gjelin që këndon?


Gimi tha: — Un' dua,  
gjelin këngëtar,  
se ka zë të bukur  
e pendë ngjyrë ar.

Mbas ca kohësh Irmës  
pulkëza e zezë,  
nisi që t'i bëjë  
për çdo ditë vezë.

Ndërsa gjel' i Gimit  
vetëm **kikiki!**  
bënte çdo mëngjes  
atje mbi çati.

Prandaj Gimi Irmës  
i foli një ditë:  
— **Gjeli** pendëartë,  
mua m'u mërzit.

— S'ke ç'i bën — tha Irma —  
mendja të gënjeu,  
se nga pendët gjeli  
më shum' të pëlqeu.




## GRENXA DHE BLETËT

Një ditë dimri  
me er' e shi,  
grenxa te bletët  
gjeti shtëpi:

— Dëgjoni, motra, —  
foli me t'mirë —

s'dua t'jetoj  
si egërsirë.  
Këtu me ju  
dua t'qëndroj  
dhe ju jap fjalën  
se do t'punoj.  
Do bëj dhe unë  
mjaltë për njerinë,  
s'e dua pyllin,  
po shoqërinë.  
I thanë bletët:  
— Mos u lodh kot,  
sepse me fjalë  
s'na gënjen dot;  
prandaj, moj grenxë,  
mos mbaj ti shpresë  
që sot nga ne  
të marrësh pjesë.  
Si than' kështu,  
bletët u ngritën  
dhe jashtë zgjoit,  
grenxën e qitën.

... Atij që ndihmën  
s'e meriton,  
secili portën  
shpejt ja tregon.




## MAÇOKU I PENDUAR

Maces një maçok  
I foli një ditë:  
— S'dua më të lodhem  
Duke ndjekur minjtë.  
Tani fare mirë  
Un' e kam kuptuar  
Se mund të jetohet  
Edhe pa punuar. —  
Maces i erdh keq,  
Prandaj e qërtoi:  
— Or maçok, pa punë,  
Askush s'mund të rrojë.

Por maçok dembeli  
S'u bë hiç merak  
Dhe si me të tallur,  
Qeshi nën mustak:  
— Koha — i tha maces —  
Shpejt do ta tregojë,  
Kush nga ne të dy  
Më mirë do rrojë.  
Kështu zu të futej  
hajdut në qymez  
Dhe nga një zog pule  
Hante çdo mëngjez.  
Por nuk zgjati shumë,  
sepse e diktuan:  
ja zbutën kurrizin  
edhe e dëbuani.  
Një dit' macja rrugës  
sheh shokun e vet,  
që ish katandisur  
tamam si skelet  
dhe i tha: — Maçok,  
a e pe tani  
se po nuk punove,  
s'të ushqen njeri? —  
Atëher' maçoku,  
që ishte penduar,

tha: — Nuk u jetoka,  
vërtet, pa punuar. —  
Dhe prap, q'atë ditë,  
zu të ndjekë mijtë.



## LUMI DHE PËRRENJTË

Një her' lumi te përrenjtë  
zuri u krenua:

— Ndihma juaj, «miq të shtrenjtë»  
s'më 'vlen fare mua!

Than' përrenjtë: — Mos u mburr,  
lumë, prit një herë,  
se pa ndihmën tonë, kurre  
s'do të kishe vlerë.

Nga lëvdatat s'hiqte dorë  
ky krenari lumë,  
që nga malet me dëborë  
rridhte gjithë shkumë...

Ndaj pérrenjtë lidhën besë  
që të ndrrojnë shtretet,  
Thanë: «Mendje le të shesë,  
kur pa ne të mbetet».

Erdhi vera, bënte nxeh të  
qielli ish pa re,  
u hollua lum' i shkretë  
sa një fije pe.

Atë ças pérrenjt' i thanë:  
— Dëgjo, lum' krenar,  
shokët vetëm po të lanë,  
krejt ke pér t'u tharë!»



## HËNA DHE TOKA


Hëna e vogël rrumbullake  
nga lart me zili,  
shihte tokën plot me jetë  
e me gjallëri.

Dhe një dit' e pyeti tokën:  
— Thuam' vall' përse  
kaq e bukur dhe e qeshur  
ti gjithmonë je?

Pranë teje nëpër shekuj  
po vërtitem unë,  
por e mjer' dhe e trishtuar  
jam gjithnjë më shumë.

I tha toka pa u mburrur:  
— E trishtuar je,  
sepse njerëz edhe jetë  
ti, moj hënë, s'ke.


Ta dish mirë, se njeriu  
kudo që jeton,  
i jep vendit gjallëri  
dhe e zbukuron.



## ZËRI DHE DRITA

Zëri dhe drita  
bënë një garë,  
se kush do zinte  
vendin e parë.  
Zëri u lëvdua:  
— Nuk mundesh ti  
të ma kalosh  
në shpejtësi!  
Drita nuk fliste,  
por ish e qetë

dhe s'i pëlqente  
të mburrej vetë.  
Shenja u dha,  
gara filloi,  
zëri dhe drita  
sekush vrapoi.  
Por ja që zëri  
(sa keq i shkreti!)  
në këtë garë,  
fort prapa mbeti;  
Drita e shpejtë,  
e urt', e qetë,  
në këtë garë  
ish fitimtare.  
por s'bëri fjalë  
e s'u mburr fare!



## GJINKALLA DHE MILINGONA

Milingonës një gjinkallë,  
na i foli pér t'u tallë:  
milingonë, moj e shkretë,  
veç në pun' të shkoi kjo jetë;  
pse s'gëzon dhe ti si unë,  
që këndoja e rroj pa punë?  
Milingona menjëherë  
iu përgjegj:  
— Gjinkall' e mjerë,  
vetëm puna t'jep në jetë  
lumturinë e vërtetë.

## PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Kazma dhe pushka .....	3
Kur jam i lumtur .....	5
Lamtumirë, shokë! .....	7
Ushtarët .....	9
Xhaxhi karrocieri .....	11
Mani dhe mjolla .....	13
Rina dhe çerdhja .....	15
Babi im .....	17
Po t'u prish karroca .....	19
Libri .....	20
Shiu .....	22
Makina e ujit .....	24
Në u bëfsha .....	26
Qukapiku .....	28

Rrushi	29
Kam dy peshq	31
Ylli i këputur	33
Si u gënje Gimi	35
Grenza dhe bletët	37
Maçoku i penduar	39
Lumi dhe përrenjtë	42
Hëna dhe toka	44
Zëri dhe drita	46
Gjinkalla dhe milingona	48

2204

Tirazhi 4000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967